

studimi



Profesori italian Giovanni Armillotta, hedh dritë mbi disa aspekte të njohura e të panjohura, misterioze dhe interesante të politikës së jashtme shqiptare në periudhën 1944-1991



Karakteristikat e politikës së jashtme shqiptare në arkivat e OKB-së



SHQIPERIA

Rol unikël gjatë Luftës së Ftohtë

ARMAND PLAKA

Profesori italian, Dr. Ph.D. Giovanni Armillotta, një njohës i mirë i problemeve të Shqipërisë, e sidomos studiuës i zellshëm i politikës së saj të jashtme, përqipet duke u bazuar në hulumtimet e studimet e bëra me këtë rast nëpër arkivat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të trajtojë karakteristikat e politikës së jashtme shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë. Duke lexuar pasazhet nga studimi i tij në gjuhën angleze: "Shqipëria dhe OKB-ja: Dy çështje studimore parë nga perspektiva diplomatiko-historike" ("The International Journal of Albanian Studies", Columbia University, Nju-Jork, 1 (1997), N. 1 (Fall): 69-81), hasim në përfundime interesante për sa i përket rolit të Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare në atë kohë. Armillotta arrin në përfundimin se ajo (Shqipëria) megjithëse kishte një regjim totalitar nga brenda, arriti për shkak të mospjesëmarrjes në blloqe e aleanca ushtarake, si dhe për arsye të tjera, të jetë një faktor stabiliteti për komunitetin ndërkombëtar në përgjithësi, e rajonin ku ajo bënte pjesë, në veçanti. Ai thekson se gjithsesi, shteti komunist, në mënyrë permanente u përpoq të siguronte atë që për breza të tërë kishte përbërë

një shtetësim të vazhdueshëm: Ekzistencën dhe ruajtjen e një shteti shqiptar të paprekur nga pretendimet e mundshme kërcënuese shoviniste të fqinjëve.

Duke trajtuar sfondin e politikës së jashtme shqiptare gjatë viteve 1944-1991 ai shkruan: Nevoja emergjente për krijimin e marrëdhënieve të reja të pushteteve në skenën globale nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, krijoi një seri problemesh në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare për vende të vogla si Shqipëria. Si po integrohej Shqipëria në sistemin e ri ndërkombëtar të pasluftës? Ishte më se e qartë, se ndodhja nën rrezikun eminent të aneksimit nga fqinjët e saj, e cila përbënte tashmë çështjen fundamentale, mund të zgjidhej vetëm me ekzistencën e një shteti.

Shqetësimi për shtetin shqiptar

Ky shqetësim mbi ekzistencën e Shqipërisë si një shtet, mbizotëroi karakterin e luftës Nacional-çlirimtare dhe strukturën e motiveve që qëndronin pas aksioneve të luftëtarëve: si të partizanëve, ashtu dhe të nacionalistëve. Më poshtë, ai thekson edhe mosbesimin që ngjallnin planet e aleatëve ndaj Shqipërisë, për të dyja palët e përfshira në Luftë. Ai hedh dritë edhe mbi përputshmërinë e mundshme të planeve britanike me ato

Biografia e autorit Kush është Giovanni Armillotta

Giovanni Armillotta është doktor në shkencat politike pranë Uni versitetit të Pizës në Itali. Kandidat për Doktor në kërkimet historike, institucionet e marrëdhëniet ndërkombëtare të Azisë e të Afrikës moderne e bashkëkohore pranë Universitetit të Kaljarit. Ai ka një biografi të pasur me tituj e vepra shkencore në fushën e historisë e të politikës e prej shumë kohësh edhe të gazetarisë. Qysh prej vitit 1995 ai është edhe drejtor - përgjegjës i revistës së arkiteturës, politikës ndërkombëtare, historisë e shken- Pizë; albanolog e gazetare. Ka bashkëpunuar e bashkëpunon akoma me shumë peri- ndorë të rendisim; "Affari Esteri" (që del në Romë, revistë që financohet nga Ministria e Jashtme Italliane), "L'Amo" (Pisa), "Balkanistica" (Universiteti i Mississipit-SHBA), "Leoo di Bergamo", "EM-Euromediterraneo" (Palermo), "The Europa Eord Year Book" (Londër), "La Gazzetta dello Sport" (Milano), "Il Governo delle cose" (Firenze), "Limes", "L'osservatore Romano" (Qyteti i Vatikanos) e shumë e shumë të tjera. Ai ka fituar Qmim të parë në Edicionin e Dytë të Konkursit Kombëtar Gazetaresk "Ar- bëresh or-line". Ai bashkëpunon tashmë me shumë gazeta në gjuhën shqipe: si "Bota Shqiptare" (del në Romë, Gazetë e Shqiptarëve në Itali), "Futbolli" (Tiranë), Revista "Futbolli Shqiptar", "Gazeta e Rie" (Frishtëni), "Illyria News" (e vetmja gazetë shqiptaro-amerikane, Nju-Jork), "The International Journal of Albanian Studies" (Botim i Columbia University, Neë York), "Noi Albanesi in Italia" (San Martino Sijomaro, Pavia), "Shqiptari i Italisë" (Romë).



sovjetike për të kënaqur "partnerët" e tyre sllavë e grekë në kuriz të shqiptarëve: Nga njëra anë, idetë fillestare e qëllimet britanike të prishme për të kënaqur elementët shovinistë e ekspan-

sionistë të rezistencës greke, të cilët mund të përdroreshin si një armë në shërbim të tyre në të ardhmen, përballë një ekspansioni të mundshëm komunist, shiheshin me dyshim të madh nga Hoxha dhe komunistët. Nga ana tjetër, përpjekjet sovjetike për të shpërblyer Titon dhe Jugosllavinë e tij që kishin si synim krijimin e një zone të influencës sovjetike në Ballkan, duke ia lënë Shqipërinë Jugosllavisë, një projekt i dëshiruar nga Stalini, por gjithashtu ndoshta edhe nga Çurçilli - u panë me dyshim të ngjashëm nga ana e nacionalistëve shqiptarë. Secila palë kishte në këtë mënyrë, një vëzhgim pjesërisht korrekt mbi të ardhmen e sistemit ndërkombëtar. Por të dyja palët ishin të verbuara nga ndjekja pikë për pikë e ideologjisë që përfaqësonin.

Ruajtja e territorit

Në situatën tepër komplekse të krijuar në atë kohë, shkruan Armillotta, Enver Hoxha dhe qeveria e tij e re, e papërvojë, zgjodhën të ndjekin në mënyrë rigorozë përm-bushjen e qëllimit të parë, që ishte, ruajtja e integritetit territorial të Shqipërisë. Për këtë arsye, në kuadrin e përgjithshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, duhet të vihet re se ky shtetësim i vazhdueshëm për çështjen e sigurisë dominoi në plan afatgjatë politikën e jashtme shqiptare të pasluftës. Fatkeqësisht, zgjedhja

e tyre ishte e mbarësuar me tone të forta ideologjike, të cilat i kthyen edhe mbrapsht. Nëse dikush përpqipet të diskutojë rolin e jugosllavëve në të gjithë këtë çështje, dhe qëllimet në politikën e tyre afatgjatë, duhet të thuhet se ideologia komuniste luajti një rol të rëndësishëm në Luftën Nacionalçlirimtare. Nacionalizmi i prekshëm i shqiptarëve bëri që komunistët shqiptarë të detyroheshin të modifikonin qëndrimin e tyre në shumë çështje kyçe të doktrinës së tyre. Kështu, paradoksi është se megjithëse qeverisëj nga komunistët, Shqipëria ishte i vetmi shtet me përmasa të vogla në të mesme, që nuk u përdor nga komunisti, si për shembull: Kuba.

Shqipëria, faktor në rajon

Mospërputhshmëria e principëve të pavarësisë absolute me principet e "sovanitetit të kufizuar" ishte një "truzim" për politikbërësit shqiptarë. Qenia e tyre besnikë të principëve të para, po e transformonte Shqipërinë në një "entitet autonom Hobbesian", një rast unik në historinë e re të diplomacisë. Shqetësimi i Shqipërisë kundrejt fqinjëve të saj është një pikë kyçe për të shpjeguar politikën e saj, madje edhe përballë organizatave ndërkombëtare dhe formacioneve aleate e blloqeve ushtarake. Gjithsesi, pavarësisht nga natyra



FAKTOR STABILITETI

Armillotta arrin në përfundimin se Shqipëria, megjithëse kishte një regjim totalitar nga brenda, arriti për një seri arsyesh asokohe, të jetë një faktor stabiliteti për komunitetin ndërkombëtar në përgjithësi e rajonin ku ajo bënte pjesë, në veçanti



ktit të Varshavës në vitin 1955 dhe anëtare gjithashtu e KNER-it. Me të gjitha efektet e tij, konsolidimi i shtetit të ri shqiptar gjatë viteve 1944-1955 ndodhi ndërsa vendi ishte nën orbitën sovjetike. Pas problemeve që shpërthyen midis Titos e BS-së gjatë viteve 1956-1961, kur nevoja për ta shfrytëzuar pozicionin e saj gjeografik ishte më se akute, Shqipëria në mënyrë progresive lëvizti jashtë sferës së ndikimit sovjetik dhe e lidhi veten me një aleancë të re, me Kinën, një aleancë që zgjati deri në vitin 1978. Aleanca e Shqipërisë me Kinën, gjithësesi, u përdor nga politikbërësit shqiptarë për të zgjidhur problemet e tyre ekonomike etë sigurisë kombëtare, në avantazhin e tyre. Megjithëse e përfshirë në një aleancë të pabarabartë bilaterale, thekson një tjetër studiues: "Kina nuk mund ta detyronte dot Shqipërinë të ndryshonte apo të reformonte politikën e saj të jashtme, ose të pengonte qoftë edhe shkëputjen e Tiranës prej vetë asaj".

Traktati i Varshavës

Pas pushtimit të Çekosllovakisë në gusht të vitit 1968, në mënyrë zyrtare, por edhe "de facto" që nga prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik në 1961, Shqipëria doli edhe nga Pakti i Varshavës dhe nuk u fut në ndonjë pakt apo aleancë tjetër ushtarake, të cilat në mënyrë direkt apo indirekte mund të ndikojnë që Shqipëria të bëhej armik i ndonjë pale të tretë. Po kështu, Shqipëria nuk aderoi në ndonjë konventë apo marrëveshje, e cila do ta lidhte atë me – pavarësisht se sa vogël ishte vetë ajo dhe roli i saj në këto aleanca – interesat e shteteve të tjerë. Për shembull, kur politikbërësit shqiptarë u bindën se (Organizata Botërore e Shëndetësisë) FAO dhe UNESCO po shfrytëzoheshin nga superfuqitë, ajo nuk hezitoi të dilte nga këto organizata ndërkombëtare të OKB-së në 1965. Duhet të vihet re gjithashtu se megjithëse dalja e Shqipërisë koïncidoi me atë të daljes edhe të disa shteteve komuniste nga kjo organizatë, ajo u bë për arsye krejt të ndryshme.

Pozicionimet diplomatike

Shqipëria nuk u pranua në OKB deri në vitin 1955. Midis viteve 1944 e 1961, Shqipëria i përkiste në mënyrë ekskluzive kampit komunist. Duke u afruar së pari me Jugosllavinë (1944-1948) e më pas me Bashkimin Sovjetik (1948-1961), Shqipëria u bë anëtare e Pa-

e regjimit të saj totalitar brenda vendit, Shqipëria ishte një element i rëndësishëm stabiliteti në rajon dhe një anëtar që gëzonte besimin e komunitetit ndërkombëtar, i cili luajti në mënyrë fare të lirë dhe pa pasojë e ndërlikime, në aleancat e pabarabarta që dominuan periudhën e Luftës së Ftohtë.

raportet diplomatike

Shqipëria vend sovran, jo vetëm formalisht

Tirana u tregua e palodhur për të theksuar e përsëritur shpesh se mospranimi i aleancave ushtarake, sidomos asaj të Paktit të Varshavës, përbënte edhe kushtin kryesor për ruajtjen e garantimit e paqes, si dhe parandalimin e tensioneve në mbarë botën. Për këtë arsye, është më se e sigurt të theksohet se Shqipëria, i vetmi vend evropian që u çlirua pa ndonjë ndihmë nga jashtë, u shfaq në arenën e zhvillimeve ndërkombëtare si një vend i lirë e sovran, dhe kjo, jo vetëm në planin formal. Qysh nga viti 1961, Shqipëria filloi të vendoste marrëdhënie diplomatike me shumicën e vendeve në botë, përveç Moskës, Londrës e Washingtonit. Duke deklaruar nga njëra anë

se i bazonte marrëdhëniet e saj në interesin reciprok dhe principet e barazisë dhe duke theksuar se Shqipëria do të ndiqte parimet e mosdërrhyrjes në punët e brendshme të vendeve të tjera, e nga ana tjetër, duke aplikuar me forcë normat e mosnjohjes të koncesioneve për kompanitë e huaja dhe koncernet multinacionale, ndalimin e ndihmave apo bashkëngjijten iniciativave ekonomike e financiare të institucioneve të huaja financiare, Shqipëria ruajti kështu në mënyrë tepër rigorozë e me xhelozji pavarësinë e saj. Udhëheqja shqiptare madje sanksiononte në Kushtetutën e saj të fundit komuniste, se kjo ishte politikë realiste.

pozicionimi

Shqipëria, unike në plan ndërkombëtar

Tirana ia arriti të krijonte një bazë të marrëdhënieve në pjesën më të madhe të botës. Ana interesante e gjithë kësaj është se Tirana i zhvilloi këto marrëdhënie mbi disa argumente që qëndronin e që ishin shumë origjinale, të cilat ishin gjithashtu shumë të njohura për të qëndruar larg premisave ideologjiko-ekonomiko-strategjike që vazhdonin të dominonin marrëdhëniet ndërkombëtare të kohës. Ajo gjithashtu i qëndroi larg etiketave disi "tërheqëse" për kohën si: pjesëmarrës në Lëvizjen e të Paan-gazhuarve, apo të Lëvizjes "Infra Movement", apo asaj të Vendeve të Botës së Tretë. Në të njëjtin kohë, Tirana vazhdoi të mbështeste vendet që kundërshtonin politikat agresive e raciste, neokolonialiste, hegjemoniste, dhe gjithçka tjetër të kësaj natyre, gjithnjë duke i

parë nga këndvështrimi i një perspektive realiste, por të mbështetur gjithnjë në argumentet marksiste-leniniste. Shqipëria i kundërshtonte asokohe të gjitha përjekjet e superfuqive (SHBA e BRSS) duke argumentuar se ata përpiqeshin të monopolizojnë dhe të kontrollonin lidheshipin botëror, duke u bërë në këtë mënyrë si të thuash, edhe arbrit i paanshëm i lojës ndërkombëtare. Në veçanti, Shqipëria kundërshtoi me forcë Bashkimin Sovjetik dhe konceptin e tij të "përgjegjësisë së veçantë" që përdorej për të justifikuar ndërhyrjet e tij në zonat e tij të influencës ndër vendet e botës së tretë. E vendosur në këtë kontekst të Luftës së Ftohtë, duhet të thuhet në fakt, se Shqipëria luajti një rol shumë unik në planin ndërkombëtar.

jashtë aleancave

Themelet e politikës së jashtme shqiptare

Në kapitullin mbi "Themelet e politikës së jashtme shqiptare gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë" autori thekson se shqiptarët zgjodhën qëllimisht të denonconin vazhdimisht me forcë të dyja superfuqitë, duke u mbajtur përveç të tjerash edhe në shpresën e një balancimi, që do t'i bënte në këtë mënyrë shqiptarët "të rrinin rehat". Në këtë kapitull, Armillotta shkruan: Karakteristika themelore e politikës së jashtme shqiptare ka qenë shqetësimi i vazhdueshëm i shqiptarëve rreth ekzistencës e sigurisë së shtetit të tyre nga përjekjet shoviniste të fqinjëve të tij për ta ndarë Shqipërinë midis tyre apo për ta aneksuar atë. Një aspekt tjetër themelor i politikës së jashtme shqiptare ka qenë edhe zhvendosja nga një periudhë intensive e "internacionalizmit proletar", që e pa Shqipërinë të shkëputej nga një aleancë e ngushtë me Jugosllavinë

(1944-1948), në një tjetër me Bashkimin Sovjetik (1948-1961) e më pas me Kinën (1961-1978) – një politikë pothuajse ksenofobe pas fundit të viteve '70-të. Duhet vënë re gjithashtu sistemi i politikbërjes shqiptare të "dogmave e besimeve": ata ishin të bindur se sistemi bipolar i Luftës së Ftohtë do të zgjaste për disa kohë, dhe njëri nga argumentet e tyre kryesorë ishte kërcënimin i dyanshëm bërthamor. Në këtë kontekst, shqiptarët zgjodhën të denonconin në mënyrë permanente "me atloparrantë" dy superfuqitë, duke pasur iluzionin e dyshimit, se në këtë mënyrë ato do të toleroheshin nga të dyja palët; Politikbërësit shqiptarë dhanë garanci se Shqipëria nuk do të bënte kështu pjesë në asnjërin prej të dyja kampeve, dhe duke menduar se në rastin e veçantë të Shqipërisë, teoria e dominosë nuk po provohet të ishte e vërtetë.